



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:077181

Datë: 06.01.2025

Numri i dokumentit: 06679481

**P.nr.188/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, dhe me pjesëmarrjen e praktikantes Gresa Bajrami, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit G. S. me vendbanim në fsh. Sh., K. P., të cilin e mbron Lindita Rexha av. ne Prishtine, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1676/2023 të datës 17.03.2023, për shkak te veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 te KPRK-se, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 03.01.2025, në prani të prokurorit te shtetit Paulin Pashku, të pandehurit dhe mbrojtëses se tij, në të njëjten datë merr dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

**G. S.**, i biri i N. dhe L. e gjinisë G., i lindur me datë ..., në Gj. me vendbanim në rr. "...", nr. .. fshatin Sh. P. ka të kryer fakultetin Ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse:**

Më datë 04.09.2022, rreth orës 13:45 min, në oborrin e restorant "...” fshatin B. Komuna e L., i pandehuri G. S., me dashje me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit, kanos seriozisht me privim nga jeta të dëmtuarin R. L., në atë mënyrë pas një mosmarrëveshje të atë çastshme në mes tyre i pandehuri i drejtohet me fjalët kërcënuese **“Çka po më kqyr...ta jepi plumbin në ballë”**, me ç’ rast tek i dëmtuari shkakton ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetën.

-me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konformë neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 181 par. 1 të KPRK- së, si dhe dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

### DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej **500.-€**, (pesëqindeuro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë, në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ne

te kunderten dënimi me gjobë konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, do te zëvendësohet ne dënim me burgim ku do të llogaritet shuma prej 20-€ për një ditë burgimi.

I dëmtuari R. L. nga P., për kërkesën pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

**DETYROHET** i pandehuri që kësaj gjykate emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën nga 20.-€, dhe në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej 20.-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.1676/23, të dt.17.03.2023 e ka akuzuar të pandehurin G. S. me vendbanim ne fsh. Sh., K. P., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 i KPRK-se.

Prokurori i shtetit në seancen e shqyrtimit fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje te plotë me te gjitha shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore konform nenit 242 të KPRK-së, si dhe i ka propozuar gjykates se me rastin e marrjes së vendimit të merr parasysh si rrethanat lehtësuese ashtu edhe rrethanat rënduese.

I pandehuri ne seancen e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajin per rastin e ndodhur, ka kërkuar falje për rastin dhe ndjen keqardhje për atë që i ka ndodhur dhe ka premtuar se nuk do ta përsërisë këtë sjellje në të ardhmen. E ka lut Gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa me te butë sepse është mbajtës i familjes 6 anetarëshe.

Mbrojtësja e të pandehurit ne seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se kërkon nga Gjykata që ta pranon fajësinë e te mbrojturit te saj dhe me rastin e marrjes se vendimit ti kete parasysh rrethanat lehtësuese sië janë pranimi i fajësisë, bashkëpunimin me organet e rendit te Policise qysh ne fillim te procedurës, faktin se i njëjti ka qene i provokuar nga pala e dëmtuar, se është mbajtës i familjes, është i moshës se re dhe ndaj tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedure tjetër dhe nuk ka precedent penal, andaj propozon Gjykates që ti shqiptoj nje dënim sa me te bute sic mund te jete vërejtja gjyqesore.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kunderligjshme, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftushme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshir në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se vepres penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, rrethanat pas kryerjes së veprës pra faktin se i njëjti eshte penduar për veprën penale, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do t'i përsërisë sjellje te tilla, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se është i moshës se re që len për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishem i shoqërisp, është mbajtës i familjes, e veçanërisht pranimin e fajsisë ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë penale të t'pandehurit, pra faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka që qenë i aftë t'i kuptoi sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i tillë konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesen pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 450 par. 1 dhe 2 pika 1 dhe 6 të KPPK-së, ku shuma prej 20.-€, për paushall gjyqësor u bazua në bazë të ndërlíkueshmerisë së rastit, ndërsa shuma prej 20.-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimet.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.188/2023, me datën 03.01.2025**

**Praktikantja**

**Gresa Bajrami**

**G j y q t a r i**

**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.